



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2022:243441

Datë: 14.05.2024

Numri i dokumentit: 05740501

C.nr.86/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC-Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, si gjykatë e shkallës së parë, me gjyqtarin Jeton Krasniqi dhe bashkëpunëtorin profesional Dardan Elshani, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.B të cilin sipas autorizimit e përfaqëson J.O nga Prishtina, kundër të paditurës Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “Hafir Shala”-Komuna e Gllogocit, me objekt kontesti anulim i vendimit Nr... të datës 19.10.2022, vendimin Nr... dhe përsëritja e konkursit për pozitën... pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik të datës 07.05.2024, në të cilën ishin të pranishëm paditësi dhe i autorizuari i tij, ndërsa në mungesë të të paditurës me datë 14.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.B nga Komuna Gllogocit.
- II. ANULOHET** vendimi i të paditurës Qendra Kryesore Familjare-Komuna e Drenasit Nr... për emërimin e nëpunësit D.Gj, UD i k... nga QKMF në Drenas, Vendimi nr... të datës 03.11.2022 i Komunës së Drenasit-Komisioni i ankesave për nëpunësit e shërbimit publik dhe konkursi i brendshëm që evidentohet me nr... i datës 12.09.2022 për pozitën k... si të kundërligjshme dhe **DETYROHET** e paditura Qendra Kryesore Familjare-Komuna e Drenasit, që të rishpallë konkursin për pozitën K... në KPSH.
- III. DETYROHET** e paditura, që paditësit t’ia paguajë shpenzimet procedurale në shumën prej 748.00 €, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kanosjen e përmbarimit të detyruar.

A r s y e t i m

Çështja gjyqësore dhe pretendimet e palëve

Paditësi me datë 18.11.2022, ka parashtruar padi kundër të paditurës të cilën e ka precizuar me parashtrësën e datës 15.03.2024, përmes së cilës ka kërkuar që të anulohet Vendimi Nr... vendimi

Nr... i datës 03.11.2022 i lëshuar nga Komuna e Drenasit-Komisioni i Ankesave dhe konkursi i brendshëm që evidentohet me nr... i datës 12.09.2022 për pozitën K... në SH.SH në K.P.SH Drenas si i kundërligjshëm dhe të obligohet e paditura që ta përsërisë konkursin për pozitën k... SH.SH në K.P.SH Drenas. Ndër të tjera në padi ka theksuar se e paditura kishte shpallur konkursin për plotësimin e vendit të punës për k... ku të njëjtin konkurs e kishte anuluar dhe kishte emëruar në këtë pozitë U.D kandidatin e preferuar nga ai, çka përbënë diskriminim ndaj kandidateve tjerë. Ka shtuar se së bashku me punëtorët tjerë të QKMF-së në Drenas paraprakisht me anë të një peticioni kishin shprehur pakënaqësitë e tyre ndaj vendimit me nr... të datës 12.09.2022 me të cilën kanë kërkuar anulimin e këtij konkursi duke shprehur të gjitha parregullsitë, ku në këtë rast QKMF në Drenas kishte shkelur nenin 19 të statutit të saj, ku përcaktohet se në këtë pozitë duhet të jetë Doktor i Mjekësisë dhe me këtë ka shkelur edhe parimet e hierarkisë së pozitave të parapara me ligjin e punës dhe ligjin për zyrtarët publik si dhe udhëzimin administrativ të MPMS nr.07/2017.

Ndërsa shqyrtimin kryesor dhe fjalën përfundimtare përfaqësuesi i paditësit ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë kërkesëpadisë dhe deklarimeve të deritanishme duke konsideruar se e paditura ka vepruar në kundërshtim të dispozitave ligjore gjatë zhvillimit të konkursit që është objekt i këtij kontesti dhe është në kundërshtim me udhëzimin administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit publik neni 6 dhe dispozita tjera si dhe në kundërshtim me qarkoren informative me nr.01/2019, neni 3.1 të saj dhe në kuptim të kësaj ky konkurs është dashur që të anulohet dhe brenda afateve ligjore të përsëritet. Meqenëse asnjëri nga kandidatet nuk ka fituar me shumë së 50% të pikëve të parapara në test, emërimi i D.Gj në kryerjen e detyrave të punës dhe përgjegjësisive të k... në QKMF është i kundërligjshëm ngase i njëjti nuk i plotëson kushtet e kërkuara për pozitën për të cilën është emëruar sepse i njëjti është me shkollim të mesëm në fushën e mjekësisë dhe bazuar në diplomën e tij T... është në kundërshtim me udhëzimin administrativ për pozitën e paraparë në konkurs si dhe në kundërshtim me nenin 19 të statutit të QKMF-Glllogoc, në të cilën decidivisht ceket që personi i cili duhet të ushtroj këtë detyrë duhet të jetë doktor i mjekësisë. Andaj ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësit të precizuar ta aprovoj si të bazuar pasi që baza juridike vërtetohet nga procedurat e administruara.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Pala e paditur, nuk ka marrë pjesë në seancat e mbajtura në këtë proces gjyqësor, por me anë të përgjigjes në padi të datës 08.03.2024 dhe parashtrësive të datës 08.04.2024 dhe 07.05.2024 ka shprehur qëndrimet e saj duke kundërshtuar në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Tutje ka shtuar se Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare ‘‘Dr. Hafir Shala’’, në Drenas kishte shpallur konkurs të brendshëm për vendet e punës si Kryeinfermier dhe k... ku pas mbylljes së konkursit e njëjta kishte publikuar listën e kandidateve të cilët i kanë plotësuar kriteret për t’iu nënshtruar testit me shkrim. Paditësi ka abstenuar në testin me shkrim me arsyen se ka pasur parregullsi dhe me këtë rast i ka humbur mundësitë ligjore për vazhdimin e mëtejshëm lidhur me konkursin në fjalë, ndërsa kandidatet tjerë të cilët i ishin nënshtruar testit me shkrim nuk kishin arritur 50% të pikëve. Lidhur me këtë komisioni përgjegjës kishte publikuar njoftimin se konkursi ka dështuar për shkak se asnjëri nga ta nuk ishte i suksesshëm. Ka shtuar se paditësi ka parashtruar ankesë lidhur me ligjshmërinë e vendimit Nr... të datës 19.10.2022, me të cilin vendim është caktuar përkohësisht zëvendësuesi i k... sipas së cilës komisioni duke refuzuar

ankesën e palës paditëse me të drejtë ka konstatuar se vendimi është i bazuar në legjislacionin në fuqi dhe në këtë rast koordinatori i cilësisë dhe sigurisë është caktuar si zëvendësues deri në ndërmarrjen e hapave të mëtutjeshëm ligjor dhe nuk ka të bëjë me konkursin e datës 12.09.2022 i cili është përfunduar pa asnjë kandidat të suksesshëm. Pastaj ka theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e palës paditëse se K... në KPSH duhet të jetë vetëm Doktor i mjekësisë për faktin se bazuar në Qarkoren Informativ Nr.01/2019, për pozitën e k... mund të konkurrojnë të gjithë profesionistët shëndetësor ose bashkëpunëtorët profesional me shkollim të lartë në menagjment shëndetësorë. Andaj, mbi bazën e kësaj ka propozuar që të refuzohet padia dhe kërkesëpadia e paditësit si e pa bazuar.

Ne lidhje me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Provat dhe gjendja faktike e vërtetuar

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë e të plotë të gjendjes faktike dhe nxjerrjes së vendimit të drejtë dhe të ligjshëm, ka administruar dhe lexuar këto prova:

Qarkorja informative e Qeverisë së Kosovës-Ministria e Shëndetësisë me nr. të protokollit 05... të datës 18.07.2019, Parashtrësia e Ministrisë së Shëndetësisë-departamenti për zhvillim strategjik shëndetësor me numër protokollit... të datës 08.07.2019, Përshkrimi i temave të referencës për k... për 3 nivelet e kujdesit shëndetësor lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë e cila nuk ka datë por i është bashkangjitur parashtrësës së lartcekur, Fletë dorëzimi i komisionit të ankesave për nëpunësit e shërbimit publik i komunës së Drenasit me nr... të datës 03.11.2022, Njoftimi i komunës së Drenasit nr... të datës 04.10.2022, Njoftimi i Komunës së Drenasit-QKMF me nr... të datës 17.10.2022, Vendimi i Komunës së Drenasit-QKMF me nr... të datës 06.07.2021, Vendimi i Komunës së Drenasit-QKMF me nr... të datës 19.10.2022, Vendimi i Komunës së Drenasit-komisioni i ankesave për nëpunësit e shërbimit publik 01... të datës 03.11.2022, Ankesa e paditësit parashtruar të të paditurës me datë 25.10.2022 me numër 01... Peticion me numër protokollit 06... të datës 24.10.2022, Kërkesa e paditësit drejtuar të të paditurës me datë 10.10.2022 me nr... Kërkesa e paditësit drejtuar të të paditurës-drejtorit të QKMF-së I.B me datë 10.10.2022 me nr... Konkurs i brendshëm për plotësimin e vendeve të punës kryeinfermier dhe koordinatori i cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore i Komunës së Drenasit-QKMF me nr... të 12.09.2022, Dokumentacioni i të paditurës lidhur me kandidatët që kanë aplikuar dhe atë kërkesa për punësim e S.N me nr... të datës 26.09.2022 me dokumentet përcjellëse, Kërkesa për punësim me dokumentet përcjellëse e paditësit A.B me numër protokollit... të datës 22.09.2022, Kërkesa për punësim me dokumentet tjera përcjellëse e A.R me nr... të datës 26.09.2022, Kërkesa për punësim me dokumentet tjera përcjellëse e F.B me nr... të datës 26.09.2022, Kërkesë për punësim me dokumente tjera përcjellëse e R.H me nr... të datës 26.09.2022, Kërkesë për punësim me dokumentet tjera përcjellëse e D.Gj me nr... të datës 26.09.2022.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Në bazë të konkursit të brendshëm Nr... të shpallur nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare-Komuna e Drenasit, për plotësimin e vendeve të punës, konstatohet se ishte shpallur konkurs për pozitën Kryeinfermier dhe K... në KPSH.

Nga njoftimi... konstatohet se ishte publikuar lista e aplikuesve të cilët kanë plotësuar kriteret sipas konkursit Nr... ku në këtë konkurs kishin aplikuar: A.R, A.B, D.Gj, F.B, R.H dhe S.N.

Në bazë të njoftimit të Qendrës Kryesore së Mjekësisë Familjare-Komuna e Drenasit Nr... të datës 17.10.2022, gjykata vërtetoi faktin se konkursi në fjalë kishte dështuar për shkak se asnjëri nga kandidatët nuk kishte fituar me shumë se 50% të pikëve të parapara në test.

Nga vendimi për kryerjen e detyrave të punës... vërtetohet se D.Gj ishte që t'i kryej detyrat e punës dhe përgjegjësisë e K... për arsye të gjendjes shëndetësore të K... në QKMF-Drenas.

Në bazë të vendimit të Qendrës Kryesore së Mjekësisë Familjare-Komuna e Drenasit... gjykata vërtetoi se D.Gj ishte caktuar Zëvendësues K... në KPSH, përkatësisht në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare "Dr. Hafir Shala", në Drenas nga data 19.10.2022, i cili vendim ishte i përkohshëm deri sa të zhvillohen procedurat e rekrutimit për këtë pozitë.

Nga vendimi i komisionit të ankesave për nëpunësit e shërbimit publik të datës 03.11.2022, gjykata vërtetoi se paditësit i ishte refuzuar ankesa si e pa bazuar, duke lënë në vendimin e Drejtorit të Qendrës Kryesore Familjare "Dr. Hafir Shala" të datës 19.10.2022.

Në bazë të kërkesës për punësim të D.Gj me nr... të datës 26.09.2022 dhe dokumenteve tjera përcjellëse, gjykata vërtetoi se paditësi ka aplikuar në pozitën K... I njëjti është kualifikim i shkollës së mesme, respektivisht ka të përfunduar shkollën e mesme profesionale të mjekësisë në shkollën "Dr. Xheladin Deda"- Mitrovicë, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me nr... të datës 26.06.1995.

Nga peticioni i datës 11.10.2022, të cilit i ishin bashkangjitur mjekët e QKMF-së në Drenas, konstatohet se të njëjtit i ishin drejtuar drejtorit të D.SH.M.S, A.H, përmes të cilit kanë kërkuar që në pozitën K... të jetë Doktor i Mjekësisë.

Baza ligjore

Ligji nr.03/L-212 i Punës është ligj themelor, i cili rregullon marrëdhënien e punës dhe parashikon kushtet në të cilat krijohen marrëdhëniet e punës, përmbajtjen e kontratës së punës, dhe rrethanat tjera të cilat përfshinë një marrëdhënie të punës. Rrjedhimisht duke u bazuar në dispozitat e Ligjit të Punës dhe atë filluar nga neni 1, parashihet se: " *Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës*

Me nenin 8 paragrafi 1 të ligjit të njëjtë parashihet " *Punëdhënësi në sektorin publik, është i obliguar që të shpall konkurs publik sa herë që pranon një punëmarrës dhe themelon një marrëdhënie të punës*", ndërsa me paragrafin 2, përcaktohet se " *Konkursi duhet të jetë i*

barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi, ashtu siç parashihet me këtë ligj dhe aktet tjera në fuqi”.

Sipas Udhëzimit Administrativ(MPMS) Nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, në nenin 5 parashihet përmbajtja e konkursit publik dhe të brendshëm. Me nenin 6 paragrafi 3 parashihet se *“Dështimi i konkursit të brendshëm ndodhë nëse asnjëri prej kandidatëve nuk ka fituar më shumë se 50% të pikëve të paraparë në test”*, ndërsa në paragrafin 4 përcaktohet se *“Organi përkatës i autorizuar me Statutin apo aktin e brendshëm është i obliguar që në afat prej 8 ditësh nga dështimi i konkursit të brendshëm të paraparë në paragrafin 3 të këtij neni të nxjerrë vendim për publikim të konkursit publik për plotësimin e vendeve të lira të punës”*.

Vlerësimi i gjykatës

Gjykata pasi që i ka analizuar të gjitha provat ka vërtetuar se e paditura Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “Dr. Hafir Shala” në Drenas me datë 12.09.2022, ka shpallur konkurs të brendshëm për plotësimin e vendeve të punës për pozitën Kryeinfiermier dhe K... shëndetësore në KPSH. Në këtë konkurs kishin aplikuar A.R, A.B, D.Gj, F.B, R.H dhe S.N, ndërsa pas mbajtjes së testit me shkrim, tani e paditura kishte njoftuar se konkursi në fjalë kishte dështuar për shkak se asnjëri nga kandidatët nuk ka fituar më shumë se 50% të pikëve të paraparë në test. Me datë 19.10.2022 Drejtori i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr. Hafir Shala”, kishte nxjerrë vendim përmes të cilit D.Gj ishte caktuar Zëvendësues K... në KPSH, në QKMF-në Drenas, i cili ishte vendim i përkohshëm, deri sa të zhvillohen procedurat e rekrutimit për këtë pozitë. Ndaj këtij vendimi paditësi kishte ushtruar ankesë duke kërkuar që të shqyrtohet ana ligjore dhe të anulohet vendimi në fjalë, ndërsa, komisioni i ankesave për nëpunësit e shërbimit publik me vendim të datës 03.11.2022, paditësit i kishte refuzuar ankesën si e pa bazuar, duke lënë në vendimin e Drejtorit të Qendrës Kryesore Familjare “Dr. Hafir Shala” të datës 19.10.2022.

Nga provat e administruara dhe bazës ligjore të cekur si më lartë, gjykata ka vlerësuar se padia e paditësit është e bazuar, ngase sipas Udhëzimit Administrativ(MPMS) Nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik në paragrafin 4 është paraparë se *“Organi përkatës i autorizuar me Statutin apo aktin e brendshëm është i obliguar që në afat prej 8 ditësh nga dështimi i konkursit të brendshëm të paraparë në paragrafin 3 të këtij neni të nxjerrë vendim për publikim të konkursit publik për plotësimin e vendeve të lira të punës”*. Andaj, në rastin konkret e paditura pas dështimit të konkursit të brendshëm Nr... në vend që brenda afateve ligjore të nxjerrë vendim për publikim të konkursit, e njëjta duke mos përfillur udhëzimin administrativ në fjalë, në mënyrë të kundërligjshme ka nxjerrë vendim me nr... përmes të cilit D.Gj ishte caktuar Zëvendësues K... në KPSH, në QKMF-në Drenas.

Gjykata vlerëson se e paditura pas dështimit të konkursit të brendshëm, me rastin e nxjerrjes së vendimit përmes të cilit D.Gj ishte caktuar Zëvendësues K... në KPSH, në QKMF-në Drenas, është përfshirë në shkelje ligjore duke ju shmangur dispozitave të Udhëzimit Administrativ(MPMS) Nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik. Andaj, mbi bazën e kësaj gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe në të njëjtën kohë ka anuluar vendimin Nr... të paditurës Qendra Kryesore Familjare-Komuna e Drenasit.

Vendimin si në pikën III të dispozitivit me të cilën është detyruar e paditura që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës është bazuar në nenin 452.1 të LPK-së dhe TAOK-së, e që ka të bëjë me shpenzimet për përpilimin e padisë shumë prej 104 €, për katër(4) seanca gjyqësore të mbajtura shumë prej 540.00 € (nga 135 € për secilën seancë), për precizimin dhe rregullimin e kërkesëpadsisë shumë prej 104 €, apo shumë e përgjithshme të tyre në vlerë prej 748.00 €.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera të cilat janë administruar në shqyrtimin kryesor, mirëpo vlerësoi se të njëjtat nuk janë relevante dhe janë pa ndikim në vendosjen meritore të kësaj çështje juridike.

Andaj, vlerësuar nga të lartë thënat duke u bazuar në nenin të 143 LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Dega në Gllgoc,
Departamenti i përgjithshëm-Divizioni civil,
C.nr.86/23 me datë 14.05.2024**

G j y q t a r i
Jeton Krasniqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh pas marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit Prishtinë.